



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:125809
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05478530

C.nr.292/2018

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI, sipas gjyqtarit Raif Fazliu, në çështjen juridike civile kontestimore të paditësve B.K.nga P. i V. dhe A.K.nga Shkupi-Gazi Baba rr.”Brigadat e Moravës Jugore” nr.76 B, Republika e Maqedonisë Veriore, kundër të paditurve K.K. dhe R.K., që të dy nga P., për vërtetimin e drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë, jashtë seancës gjyqësore me datë 20.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPREHET procedura kontestimore e paditësve B.K.dhe A.K.nga Shkupi-Gazi Baba, ndaj të paditurve K.K. dhe R.K., që të dy nga P., pas vdekjes së të paditurit R.K., i cili ka vdekur më datë 27.01.2019, në Heidelberg të Gjermanisë.

II. Pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi lënda me shenjë C.nr.292/2018, do të arkivohet në arkivin e kësaj gjykate.

- Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës të krijuara deri më tani.

A r s y e t i m

Paditësit B.K.dhe A.K.nga Shkupi-Gazi Baba, e Maqedonisë Veriore përmes padisë së ushtruar më datë 02.08.2018, ka kërkuar nga gjykata tju vërtetohet e drejta e pronësisë në paluajtshmëri në bazë të trashëgimisë, duke i paditur K. dhe R.K., që të dy nga P. i V..

Gjykata disa herë ka provuar që të paditurve t’ju dorëzoj padinë për përgjigje, por zarfet komplet na janë kthyer me arsyetimin e shërbimit për dorëzimin e postës se të paditurit kanë udhëtuar, duke nënkuptuar se ata punojnë dhe veprojnë në botën e jashtme. Me datë 29.03.2019, pastaj me datë 03.03.2021 dhe herën e fundit me datë 15.02.2024, nga shërbimi postar në zarfet e kthyer shkruante se i padituri R.K.ka vdekur. Gjykata për ta vërtetuar kë fakt, nga Zyra e Gjendjes Civile në Viti, ka kërkuar me shkrim dhe është njoftuar se i padituri R.K., ka vdekur më datë 27.01.2019, në Heidelberg të Gjermanisë, duke na dërguar certifikata e vdekjes me nr. serik V 10668531, me nr. rendor 5, e datës 15.03.2024, nga regjistri i të vdekurve, ku konstatohet se i padituri kishte vdekur më datë 27.01.2019.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, që të ndërpritet procedura kontestimore, për shkak të vdekjes së të paditurit.

Pasi që gjykata ka kosntuar se paditësi R.K.ka vdekur, në bazë të nenit 277, paragrafi 1. pika a) të LPK-së, gjykata e ka ndërprerë procedurën dhe ka vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI

C. nr.292/2018

Më:20.03.2024

Gj y q t a r i
Raif Fazliu

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, 15 ditë pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.